
BULETIN INFORMATIV

KORRIK 2026

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të
Akademisë së Shkencave të
Shqipërisë**

Korrik, 2026

Përmbajtje

Aktivitet	6
Akademia e Shkencave e Shqipërisë pjesë e takimit europian mbi politikat e kërkimit dhe inovacionit, "Për Lirinë e Pestë Europiane dhe Garën Globale: Zërat nga Shkenca"	7
Akademia e Shkencave bëhet pjesë e Crossref, një hap i rëndësishëm për rritjen e standardeve të botimeve shkencore	9
Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron prof. dr. Nikolla Qafokun për zgjedhjen në Washington State Academy of Sciences	10
Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike voton pro kandidaturës së prof. dr. Nikolla P. Qafokut për anëtar të jashtëm të ASHSH-së	12
Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë uron anëtarët e sapozgjedhur të Akademisë së të Rinjve.....	14
Institutet dhe komisionet	16
U zhvillua veprimtaria përkujtimore shkencore kushtuar 100-vjetorit të lindjes së bas-baritonit Lukë Kaçaj.....	17
U zhvillua sesiioni shkencor me temën “Prurje dhe qasje të reja metodologjike në studimet e sotme albanologjike”	19
Botime të reja	22
Botohet libri “Studime mbi sistemin foljor dhe disa çështje të tjera të shqipes së vjetër (shekujt XVI-XVII)”, me autore Ina Arapi	23
Botohet “Kultura dhe qytetërimi arbëror në mesjetë”	24
“Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (tetor 1880), vëllimi V”	26
Botohet nga Akademia e Shkencave libri “Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (korrik-shtator 1880), vëllimi IV”	27

Botohet nga Akademia e Shkencave “Gjeomorfologjia e Kosovës” me autor Gjovalin Gruda.....	28
“Aspekte të artizanatit qeramik në territorin e Shqipërisë nga antikiteti në mesjetë”, me autor Eduard Shehi.....	29
“Mahir Domi, Vepra VII, studime gjuhësore”	30
“Mahir Domi, Vepra VI, studime gjuhësore”	31
Botohet libri “100 vjet teatër në Shkodër (1879-1979)”, me autor Andrea Skanjeti	32
Botimet më të reja të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	34
“Letërsi e vjetër shqipe në kontekst ballkanik dhe europian (shek. XVI-XVII)”, nga prof. as. dr. Evalda Paci	35
Botohet partitura e simfonisë “Albanoi” e kompozitorit Vasil S.Tole	36
Botohet libri “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe IV”	37
“Pesha e fjalës shqipe” nga akad. Gjovalin Shkurtaj.....	38
Të tjera.....	39
Prof. dr. Fjoralba Cakoni, anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mban ligjëratën “Sonia Kovalevsky” në SIAM 2026	40
Më 28 korrik 1922, Shqipëria u njoh zyrtarisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nisi marrëdhëniet diplomatike	41
Gjirokastra në UNESCO: 21 vjet pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore	42
Berati, dëshmi e qytetërimit dhe e trashëgimisë kulturore.....	43
Kujtojmë ditën e themelimit të Klubit “Bashkimi” të Manastirit.....	44
Më 10 korrik 1952 u ngrit Kinostudioja “Shqipëria e Re”, themeli i kinematografisë shqiptare	46
Akademia e Shkencave e Shqipërisë urime për akademikë dhe personalitete në muajin korrik.....	48
Podcast.....	49
Podcast AKADEMIA 3: Intervistë me akad. Ilia Mikerezin	50
Podcast AKADEMIA 4: Intervistë me akademik Rrapo Ormëni.....	51
Podcast AKADEMIA 5: Intervistë me akademik Besnik Baraj dhe prof. dr. Melissa J. Perry.....	52
Podcast AKADEMIA 6: Intervistë me akademik Gëzim Hoxha.....	53

Podcast AKADEMIA 7: Intervistë me akademik Shaban Sinani	54
In Memoriam	55
Ndahet nga jeta akademik Emin Riza, studiuesi i shquar i trashëgimisë kulturore	56
Fjala e akademik Gëzim Hoxhës në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në ceremoninë e lamtumirës së akademikut Emin Riza	58
Telegram ngushëllimi nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës për ndarjen nga jeta të akademik Emin Riza.....	61
Ndahet nga jeta studiuesi i letërsisë shqipe Ali Xhiku	63
Përkujtimi i akademikëve dhe personaliteteve të shquara gjatë muajit korrik.....	65

Aktivitet

Akademia e Shkencave e Shqipërisë pjesë e takimit europian mbi politikat e kërkimit dhe inovacionit, "Për Lirinë e Pestë Europiane dhe Garën Globale: Zërat nga Shkenca"



Më 29 qershor 2026, Akademia e Shkencave e Shqipërisë e përfaqësuar nga akad. Mimoza Hafizi mori pjesë në takimin ndërkombëtar mbi politikat e kërkimit dhe inovacionit në Europë. Takimi me temë "Për lirinë e pestë europiane dhe garën globale: Zërat nga shkenca" i zhvilluar në Bruksel u organizua nga Këshilli Evropian i Shkencës (ERC) dhe Akademia Kombëtare e Shkencave e Gjermanisë- Leopoldina. Aktiviteti bëri bashkë mbi 100 përfaqësues nga vende të ndryshme të BE dhe përtej saj si edhe nga India, Japonia etj. Takimi u zhvillua në pesë panele tematike, të fokusuara në çështjet kryesore të debatit mbi të ardhmen e shkencës dhe inovacionit.

Takimi u hap me fjalët përshëndetëse të Presidentes së Këshillit Evropian të Kërkimit, znj. Maria Leptin dhe të znj. Bettina Rockenbach, Presidente e Akademisë Kombëtare Gjermane të Shkencave, Leopoldina, të cilat theksuan rëndësinë e forcimit të kërkimit shkencor, inovacionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për përballimin e sfidave globale.

Tematika kryesore e takimit e dedikuar konceptit të Lirisë së Pestë Europiane, përmbledhi diskutime që lidheshin me zhvillimin e lirë të dijes, kërkimit, inovacionit dhe talentit, duke mëshiruar ambiciet e Evropës për të përballuar sfidat e një periudhë të karakterizuar nga konkurrenca dhe tensionet globale.

Diskutimet u përqëndruan gjithashtu edhe në ravijëzimet ku do të synohet fokusi i Programit të Dhjetë Kuadër të Bashkimit Evropian për Kërkimin dhe Inovacionin (FP10 – Horizon Europe), si edhe për angazhimin e përgjithshëm të Komisionit Evropian në fushën e shkencës. FP10 është një nga programet më të rëndësishme ku bazohet politika evropiane për kërkimin dhe inovacionin e cila synon rritjen e konkurrueshmërisë dhe autonomisë strategjike të Evropës përmes inovacionit dhe kërkimit shkencor, si dhe mbështet fuqishëm bashkëpunimin ndërkombëtar në shkencë dhe teknologji në kushtet e paqëndrueshme gjeopolitike.

Në përfundim aktiviteti u mbyll me 10 konkluzione, të cilat do të shërbejnë si rekomandime këshillimore për hartimin e politikave të Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

Akademia e Shkencave bëhet pjesë e Crossref, një hap i rëndësishëm për rritjen e standardeve të botimeve shkencore



Akademia e Shkencave e Shqipërisë është bërë pjesë e Crossref, organizatës ndërkombëtare që administron identifikuesit dixhitalë të objekteve shkencore (DOI – Digital Object Identifier), duke shënuar një hap të rëndësishëm në rritjen e standardeve të botimeve shkencore dhe të dukshmërisë së tyre në nivel ndërkombëtar.

Në kuadër të këtij anëtarësimi, të gjitha revistat shkencore të botuara nga Akademia e Shkencave gjatë vitit 2026 janë pajisur me identifikues DOI. Kjo u mundëson artikujve shkencorë identifikim të përhershëm, citim të standardizuar dhe akses më të lehtë në platformat ndërkombëtare të kërkimit shkencor, duke rritur ndikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të kërkimit.

Ky zhvillim përfaqëson një tjetër hap të rëndësishëm në angazhimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për të përmbushur standardet më të larta të botimit shkencor dhe për të forcuar integrimin e kërkimit shkencor shqiptar në hapësirën ndërkombëtare të shkencës.

Revistat shkencore të botuara nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë mund t'i gjeni në këtë link: <https://journals-akad.gov.al/>

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron prof. dr. Nikolla Qafokun për
zgjedhjen në Washington State Academy of Sciences**



Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron dhe përgëzon prof. dr. Nikolla (Niko) Qafokun për zgjedhjen e tij si anëtar i Washington State Academy of Sciences (WSAS), një vlerësim i lartë që i akordohet personaliteteve me kontribute të shquara shkencore dhe ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e shkencës dhe të shoqërisë.

Prof. dr. Qafoku është një nga pesë studiuesit e Pacific Northwest National Laboratory (PNNL) që u zgjodhën këtë vit në WSAS, në vlerësim të kontributeve të tij shumëvjeçare në shkencat e mjedisit, mbrojtjen e tokës dhe ujërave, rehabilitimin e zonave të ndotura, bujqësinë e qëndrueshme dhe proceset e dekarbonizimit. Kërkimet e tij mbi transportin dhe sjelljen afatgjatë të elementeve radioaktive dhe metaleve në tokë e ujërat nëntokësore kanë dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në strategjitë e rehabilitimit mjedisor, vlerësimin e riskut dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

Përveç detyrës si Laboratory Fellow në Pacific Northwest National Laboratory, prof. dr.

Qafoku është profesor i asociuar në University e Washingtonit, pedagog i jashtëm në Universitetin Shtetëror të Washingtonit, si dhe profesor në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë vlerëson veçanërisht bashkëpunimin e gjatë dhe të frytshëm të prof.dr. Qafokut me institucionin tonë. Ai ka qenë një mbështetës i rëndësishëm i reformimit dhe ndërkombëtarizimit të veprimtarisë shkencore të Akademisë, duke marrë pjesë aktive në konferenca, forume dhe veprimtari të përbashkëta shkencore, si dhe në nismat e organizuara në bashkëpunim me rrjetin Alb-Shkenca.

Prof. dr. Qafoku është gjithashtu anëtar i Bordit Editorial të revistës Albanian Journal of Natural and Technical Sciences (AJNTS) dhe Kryeredaktor i Seksionit të Shkencave të Mjedisit në këtë revistë, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e cilësisë shkencore dhe ndërkombëtarizimin e saj.

Në vlerësim të kontributit të tij të shquar shkencor dhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike ka miratuar propozimin për zgjedhjen e prof. dr. Nikolla Qafokut si Anëtar i Jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, procedurë që pritet të përmbyllet sipas statutit të Akademisë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë i shpreh prof. dr. Nikolla Qafokut urimet më të përzemërta për këtë vlerësim të ri ndërkombëtar dhe i uron suksese të mëtejshme në veprimtarinë e tij shkencore, duke shprehur bindjen se bashkëpunimi i tij me Akademinë do të vijojë të kontribuojë në zhvillimin e shkencës shqiptare dhe në forcimin e lidhjeve me komunitetin shkencor ndërkombëtar.

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike voton pro kandidaturës së prof. dr. Nikolla P. Qafokut për anëtar të jashtëm të ASHSH-së



Sot, më 3 korrik 2026, u zhvillua mbledhja e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me pjesëmarrje fizike dhe online, e drejtuar nga akad. Neki Frashëri, kryetar i Seksionit. Në rendin e ditës ishin shqyrtimi i propozimit për dhënien e mirënjohjes “Nderi i Akademisë” për prof. Maurizio Lambardi dhe votimi mbi propozimin për zgjedhjen e prof. dr. Nikolla P. Qafokut si anëtar i jashtëm i Akademisë.

Propozimi për dhënien e mirënjohjes “Nderi i Akademisë” për prof. Maurizio Lambardi, i ardhur nga komisioni i biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë, u shqyrtua nga anëtarët e pranishëm, të cilët miratuan unanimisht dhënien e kësaj mirënjohjeje. Më pas u paraqit kandidatura e prof. dr. Nikolla P. Qafokut nga Sekretarja Shkencore, akad. Anila Hoda. Ajo u shpreh se veprimtaria shkencore e dr. Nikolla Qafokut është përqendruar në studimin e proceseve kimike dhe mineralogjike të tokës, sjelljen dhe transportin e ndotësve në mjedis, remediimin e zonave të ndotura me radionuklide dhe metale të rënda, si dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike në ciklet biogjeokimike. Ajo vuri në dukje kontributin e tij në kuptimin e mekanizmave të transportit të uraniumit, kromit, jodit dhe teknciumit në tokë dhe ujërat nëntokësore, duke ndihmuar në zhvillimin e strategjive për mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve ujore.

Po ashtu, u theksua rëndësia e angazhimit të tij në projektet e remediimit të zonave të ndotura, veçanërisht në kompleksin bërthamor të Hanford-it në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kërkimet e tij kanë ndikuar në strategjitë e pastrimit mjedisor dhe në politikat për menaxhimin afatgjatë të mbetjeve bërthamore dhe mbrojtjen e ujërave nëntokësore.

Akad. Hoda, në fjalën e saj, theksoi se ai ka një veprimtari të gjerë akademike dhe shkencore ndërkombëtare si autor i mbi 115 artikujve shkencorë të botuar në revista prestigjioze, si Science, Nature Communications dhe Environmental Science &

Technology. Punimet e tij përbëjnë referenca të rëndësishme në fushën e shkencave të tokës dhe të mjedisit, ndërsa ka kontribuar edhe në botimin e librave, enciklopedive shkencore dhe raporteve teknike për institucione shtetërore dhe organizata ndërkombëtare.

Në vijim të diskutimeve, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, dhe anëtarët e tjerë të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, akad. Besnik Baraj dhe akad. Ilirjan Malollari, u shprehën pozitivisht për kandidaturën, duke vlerësuar kontributin e tij në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe në afrimin e diasporës shkencore shqiptare.

Në fund të diskutimeve, anëtarët e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike votuan pro pranimit të prof. dr. Nikolla Qafokut si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kandidatura e tij do t'i kalojë për miratim Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë uron anëtarët e sapozgjedhur të Akademisë së të Rinjve



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi zhvilloi një takim me anëtarët e sapozgjedhur të Akademisë së të Rinjve. Në takim morën pjesë zëvendëskryetari i ASHSH-së akad. Vasil Tole, sekretarja shkencore akad. Anila Hoda, si dhe anëtarët aktualë të Akademisë së të Rinjve.

Takimi erdhi menjëherë pas mbledhjes së komisionit të ngritur nga Akademia e Shkencave, i cili një ditë më parë përfundoi procesin e konkursit për pranimin e anëtarëve të rinj. Në përputhje me kriteret e Statutit të Akademisë së Shkencave dhe “Kartës Themelore të ALLEA-s”, komisioni përzgjedhi kandidatët fitues, të cilët tashmë janë bërë pjesë e Akademisë së të Rinjve.

Anëtarët e rinj të Akademisë së të Rinjve janë: Ervisa Ndoka, Blisard Zani, Elona Shehu, Morena Breshanaj, Enxhia Sala, Xhilda Dharmo, Marjol Meço, Andi Hida, Xhon Skënderi, Olta Qejvani, Ermiona Brahल्ली dhe Irena Myzeqari. Akademisë së të Rinjve iu bashkuan gjithashtu edhe dy anëtarë nga jashtë vendit Xhoela Bame dhe Andi Rroku. Gjatë takimit, anëtarët e rinj u njohën me misionin dhe veprimtarinë e Akademisë së të Rinjve, me të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga anëtarësimi, si dhe me mundësitë që ofron kjo platformë për zhvillimin profesional dhe shkencor.

Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, pasi u uroi mirëseardhjen anëtarëve të rinj, theksoi se Akademia e të Rinjve merr një rëndësi të veçantë në kushtet

e fenomenit të njohur si “ikja e trurit”, duke sqaruar se kjo nuk nënkupton se largohen vetëm më të zgjuarit, por se ndër më të mirët ka më shumë mundësi dhe oferta, sidomos për ata që kryejnë studimet e larta jashtë vendit. Ai nënvizoi se një nga synimet e Akademisë është të krijojë mundësi që studiuesit shqiptarë, pavarësisht se ku ndodhen, të vijojnë të japin kontributin e tyre në zhvillimin e shkencës dhe arsimit në Shqipëri. Sipas tij, Akademia përpiqet që në njësitë dhe komisionet e ngritura të përfshijë edhe kolegët që jetojnë jashtë vendit, duke vlerësuar se tashmë Shqipëria ka profesorë dhe studiues të suksesshëm në të gjitha fushat dhe se nuk ekziston më perceptimi i viteve të mëparshme se suksesi shkencor për shqiptarët ishte një mision i pamundur.

Duke u ndalur te sfidat e kërkimit shkencor, akad. Gjinushi u shpreh se kushtet për zhvillimin e tij duhet të përmirësohen, pasi Shqipëria mbetet ende pas jo vetëm në krahasim me vendet e Bashkimit Evropian, por edhe me vendet e rajonit, si për sa i përket infrastrukturës laboratorike ashtu edhe ambienteve të tjera kërkimore. Ai vuri në dukje se financimi për kërkimin shkencor është ende i pamjaftueshëm, ndërkohë që Evropa synon investimin e 3% të PBB-së në këtë sektor. Sipas tij, Akademia e Shkencave ka propozuar që Shqipëria të arrijë të paktën nivelin minimal prej 1% të investimeve për kërkimin shkencor, të cilin e konsideroi jetik për zhvillimin e këtij sektori.

Kryetari i ASHSH-së u ndal edhe te prioriteti për ngritjen e dy qendrave të reja, atë të nanoteknologjisë dhe të shkencave të jetës, të cilat, sipas tij, do të zhvillohen në bashkëpunim me universitetet, ndërsa personeli kryesor do të mbështetet edhe te bashkëpunëtorët nga jashtë vendit. Ai bëri të ditur se Akademia numëron 178 anëtarë të komisioneve, prej të cilëve 52 janë akademikë, ndërsa pjesa tjetër përfaqëson hapësirën akademike dhe institucionet e arsimit të lartë.

Në përfundim, akad. Gjinushi theksoi se Akademia e Shkencave synon të luajë rolin e promotorit të kërkimit shkencor në vend dhe të mbetet oponentja kryesore ndaj qeverisë për rritjen e investimeve dhe ndërmarrjen e reformave të nevojshme, me qëllim afrimin e Shqipërisë me standardet logjistike dhe kapacitetet njerëzore të institucioneve homologe ndërkombëtare.

Anëtarët e rinj të Akademisë së të Rinjve u përshëndetën edhe nga zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Vasil Tole dhe sekretarja shkencore, akad. Anila Hoda. Ata vlerësuan rëndësinë e përfshirjes së brezit të ri në veprimtarinë shkencore dhe u uruan anëtarëve të rinj sukses në rrugëtimin e tyre akademik, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe angazhimit të tyre në zhvillimin e shkencës.

Institutet dhe komisionet

U zhvillua veprimtaria përkujtimore shkencore kushtuar 100-vjetorit të lindjes së bas-baritonit Lukë Kaçaj



Veprimtaria përkujtimore kushtuar jetës dhe veprës së bas-baritonit të shquar shqiptar Lukë Kaçaj u mbajt më 1 korrik 2026, me organizimin e Qendrës së Studimit të Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Takimi, me praninë e studiuesve, artistëve dhe familjarëve, u zhvillua në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së artistit, me synimin për të vlerësuar dhe evidentuar kontributin e jashtëzakonshëm të tij në zhvillimin e artit lirik shqiptar, interpretimet e spikatura skenike e koncertale, si dhe trashëgiminë e çmuar artistike e kulturore që ai ka lënë në kujtesën kombëtare. Aktiviteti u moderua nga dr. Kreshnik Duqi, i cili nënvizoi traditën e krijuar nga Qendra e Studimit të Arteve për të kujtuar artistët që kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshme. Ai e vlerësoi Lukë Kaçajn si një nga figurat më të mëdha të artit lirik, që me zërin e tij të rrallë la gjurmë të pashlyeshme në historinë e operës shqiptare. Hapja e veprimtarisë u bë me interpretimin e një fragmenti muzikor nga Lukë Kaçaj në filmin “Skënderbeu”. Më pas drejtori i Qendrës së Studimit të Arteve akad. Stefan Çapaliku, iu referua kujtimeve të takimit të parë me Lukë Kaçaj, gjatë viteve të diktaturës, të cilin e njohu në rrethana krejtësisht atipike për një artist të madh si ai. Duke shprehur keqardhjen që nuk e pati njohur kurrë në skenë, por fati e deshi që një ditë ta kishte bashkudhëtar në tren, akad. Çapaliku rrëfeu takimin dhe bisedat e veçanta me Lukë Kaçaj, duke e vënë theksin tek personaliteti i palëkundur i artistit, talenti i shumëpërfolur dhe harresa e ndëshkimet e pamerituara që i bëri diktatura. Veprimtaria vijoi me përshëndetje muzikore nga sopranoja Eva Golemi dhe pianistja Herta Cane, të cilat interpretuan veprën “Dielli ka perëndue” të Prenkë Jakovës. U shfaq gjithashtu dokumentari i shkurtër “Me artistin e madh, Lukë Kaçaj – Nderi i Kombit”. Më pas, sopranoja Eva Golemi dhe baritoni Armando Lika interpretuan veprën “Kur perëndon Dielli” të Leonard Dedës, të shoqëruar në piano nga Herta Cane. Akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe kryetar i Komisionit të Arteve pranë saj, mbajti fjalën përshëndetëse. Ai vendosi krijimtarinë dhe dënimin e Lukë Kaçajt në kontekstin e diktaturës, duke përmendur edhe emra të tjerë

artistësh të shquar që u persekutuan. Akad. Tole përshkroi udhëtimin artistik të Kaçajt, jetën e tij në skenë dhe jashtë saj, rikthimin prekës në Teatrin e Operës dhe Baletit pas rënies së diktaturës, si dhe kalvarin e vuajtjeve që ai përjetoi. Ai foli më tej për vendin që zënë interpretimet dhe individualiteti artistik i Lukë Kaçajt në historinë e muzikës shqiptare.



Aktiviteti përkujtimor vijoi me kujtime të bashkëkohësve dhe familjarëve. Familjarët e Kaçaj falënderuan Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për nderimin që i bëjnë artistëve, e sidomos atyre të persekutuar nga diktatura. Veprimtaria u mbyll me interpretimin e këngës “Hej ju male” të Çesk Zadejës nga Armando Lika (bas), i shoqëruar në piano nga Herta Cane.

U zhvillua sesioni shkencor me temën “Prurje dhe qasje të reja metodologjike në studimet e sotme albanologjike”



Veprimtaria u zhvillua sot, më 9 korrik 2026, nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Sesioni u hap nga prof. dr. Tomorr Plangarica, i cili përshëndeti pjesëmarrësit dhe vlerësoi kontributin e organizatorëve dhe të gjithë të pranishmëve në këtë sipërmarrje shkencore.

Veprimtarinë e përshëndeti akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, i cili e vlerësoi si një nismë të rëndësishme për të evidentuar zhvillimet më të fundit në albanologji dhe për të krijuar një hapësirë dialogu ndërmjet studiuesve, duke nënvizuar se ky sesion është dëshmi e ndërthurjes së përvojës së konsoliduar me qasjet e reja metodologjike dhe se gjuha mbetet një nga shtyllat themelore të albanologjisë, por e lidhur ngushtë me fushat e tjera ndërdisiplinore që ndërtojnë tablonë e identitetit kulturor e historik të shqiptarëve. Akad. Hoxha e vlerësoi edhe programin e veprimtarisë për pasurinë tematike nga stilistika, analiza e diskursit, sintaksa, semantika e frazeologjia, deri te leksikografia, teoria e komunikimit, etnolingusitika dhe didaktika e gjuhës, duke vënë në qendër të vëmendjes edhe veprat më të reja shkencore, të cilat i nënshtrohen analizës kritike dhe debatit akademik, çka është tregues i vitalitetit të kërkimit shkencor në fushën e albanologjisë.

Prof. dr. Artur Lama hapi sesionin shkencor me ligjëratën mbi prurjet dhe qasjet e reja në studimet gjuhësore shqiptare, nëpërmjet një studimi të zgjeruar të zhvillimeve më të fundit në këtë fushë. Ai solli në vëmendje korpusin e veprave të botuara në vitet e fundit – monografi, përmbledhje studimore, fjalorë të specializuar dhe krestomaci – të cilat dëshmojnë se gjuhësia shqiptare po hyn në një fazë të re metodologjike. Lama evidentoi kontributet e autorëve të këtyre veprave, duke i parë si pjesë të një strategjie të konsoliduar për pasurimin e studimeve gjuhësore.



Prof. dr. Lama u ndal veçanërisht te leksikografia, duke e parë si një fushë ku është arritur një progres i dukshëm nga konferenca e parë kombëtare e vitit 2004 deri te botimi i “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe” në vitin 2025, të cilin e cilësoi si një arritje historike dhe si “regjistrin e parë” të pasurisë leksikore e frazeologjike të shqipes. Ai theksoi se ky zhvillim është shoqëruar edhe me vetëkritikë konstruktive, duke identifikuar boshllëqe të tilla si mungesa e fjalorëve për fëmijë e nxënës, mungesa e fjalorëve të huazimeve pas viteve '90, si dhe nevoja për fjalorë të specializuar në fusha të ndryshme. Në vijim, ai trajtoi çështjen e liberalizmit leksikor dhe purizmit, duke sjellë shembuj nga fjalorët e rinj si Fjalë ari (2024), që ruan proverba dhe njësi frazeologjike të folklorit, dhe Fjalori i gjuhës së Ndre Mjedës (2023), që pasuron gjuhën letrare me

trashëgiminë e Mjedës. Ai vuri në dukje se huazimet, sidomos anglicizmat, janë një fushë ku shqipja duhet të ruajë ekuilibrin mes pasurimit dhe normës, duke përmendur si shembull Fjalorin e anglicizmave (2025), pjesë e projektit ndërkombëtar GLAD.

Në fund të ligjëratos, Lama formuloi disa rekomandime të qarta si: nevoja për hartimin e fjalorëve etimologjikë, historikë e terminologjikë si program shtetëror; përgatitja e brezit të ri të studiuesve për gjuhësinë e aplikuar përmes programeve doktorale; sistemimi i trashëgimisë albanologjike të huaj, si në rastin e Dozonit dhe arkivave franceze e gjermane, si dhe forcimi i bashkëpunimit me diasporën shkencore përmes mekanizmave të qëndrueshëm. Seanca seanca e parë, u drejtua nga prof. dr. Tomorr Plangarica, prof.asoc. Dr. Orjeta Baja dhe dr. Aurela Basha.

Studiues të fushës si prof. dr. Tomorr Plangarica, prof. dr. Artan Haxhi, dr. Rozana Rushiti dhe prof. dr. Tefë Topalli, prof.asoc.dr. Orjeta Baja, dr. Resul Telhaj, prof. dr. Artur Lama, dr. Behar Hoxha trajtuan vështirësitë stilistike në gjuhësinë e diskursit, trashëgiminë e prof. Tomorr Osmanit, dimensionin shkencor të veprës së prof. Tefë Topallit, semantikën e njësive frazeologjike në veprën e Lumit Aleksandër Sirdani, kontributin e prof. Mehmet Çelikut në sintaksën e shqipes, karakterizimin e diskursit letrar shqip dhe figurën e August Dozonit si albanologu i parë francez që trajtoi gjuhën shqipe etj.

Seanca e dytë, e drejtuar nga prof. dr. Juliana Kume, dr. Dhimitër Bello dhe dr. Teuta Toska, solli referime nga studiues të fushës si prof. dr. Valter Memisha, dr. Mimoza Kore, dr. Dhimitër Bello, prof. dr. Erzen Koperaj dhe dr. Zamira Shkreli, prof. dr. Juliana Kume, dr. Aurela Basha, dr. Teuta Toska dhe dr. Rafaela Marteta. Në kumtesat e tyre u trajtuan ecuria shkencore e teorisë dhe praktikës leksikografike, fjalori i anglicizmave si prurje e re në leksikografinë e huazimeve, trajtimi leksikografik i homonimeve leksikore, fjalori i gjuhës së Ndre Mjedës si dëshmi e kontributit letrar e gjuhësor, konceptet teorike të komunikimit në veprën e prof. Agron Duros, shkolla si hapësirë diskursive, korpusi albanologjik si gur themeli për studime etnolinguiste dhe ditarët hulumtues mbi përvetësimin e gjuhës në fëmijëri.

Veprimtaria vijoi me diskutime dhe reflektime mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërbrezor për studimet e ardhshme albanologjike dhe për konsolidimin e metodologjive bashkëkohore në kërkimin shkencor, ku u nënvizua hapja ndaj metodologjive bashkëkohore dhe sfidave të reja.

Sesioni shkencor u mbyll me vlerësime të përvojës së konsoliduar dhe trashëgimisë albanologjike dhe u nxorën konkluzionet.

Botime të reja

Botohet libri “Studime mbi sistemin foljor dhe disa çështje të tjera të shqipes së vjetër (shekujt XVI-XVII)”, me autore Ina Arapi



Autorja jep një tablo mjaft të pasur me të dhëna faktike të shqipes së vjetër të veriut në krahasim edhe me gjendjen gjuhësore në periudhën e Rilindjes dhe në kohën e sotme, duke vërejtur një frekuencë të lartë përdorimi të këtij lokucioni që te Buzuku.

Megjithatë, për të kuptuar më mirë rrethanat e shfaqjes së tij në toskërishte e sheh të nevojshme të ndiqen tekstet e vjetra toske deri në periudhën e Rilindjes, të cilat në shek. XVIII na kanë mbërritur në një numër tepër të kufizuar.

Libri i Ina Arapit do t’ju vlejë jo vetëm studiuesve, pedagogëve e studentëve të gjuhës shqipe, veçanërisht të shqipes së vjetër e të gramatikës historike të saj, por edhe çdo lexuesi të interesuar për të mësuar më shumë rreth kësaj fushe tërheqëse e plot të panjohura, që me punën këmbëngulëse të studiuesve të pasionuar si autorja e vëllimit, po ndriçohen hap pas hapi.

Viti: 2025

Faqe: 353

ISBN: 9789928873064

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Botohet “Kultura dhe qytetërimi arbëror në mesjetë”



-Përgatiti: Edmond Malaj

Në këtë botim paraqiten aktet e konferencës ndërkombëtare shkencore “Kultura mesjetare në hapësirat arbërore”, të cilat kanë si synim nxitjen dhe mundësimin e prurjeve të reja studimore nga studiues shqiptarë mbi historinë mesjetare të trojeve shqiptare, me theks të veçantë në aspektin kulturor, ekonomik dhe politik.

Ky angazhim ishte një nismë e drejtpërdrejtë e Departamentit të Mesjetës dhe të Rilindjes në Institutin e Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë “Ali Hadri” të Republikës së Kosovës. Qëllimi i saj ishte prezantimi i risive studimore për periudhën mesjetare, nga shek. IV deri në fund të shek. XV.

Në konferencë dhanë kontributin e tyre pesëmbëdhjetë studiuese dhe studiues nga Shqipëria dhe Kosova, të cilët janë ndër specialistët më të mirë të fushës që kanë vendet tona.

Përmes qasjeve metodologjike të ndryshme dhe tematikave të larmishme, këto studime ndriçojnë aspekte të jetës kishtarë, politike, urbanistike, gjuhësore dhe ekonomike në

hapësirat shqiptare, nga Dardania deri te diaspora arbërore në Venecia.

Qasjet historike dhe juridike qëndrojnë në qendër të analizave të pasqyruara në këtë përmbledhje kumtesash.

Viti: 2026


Faqe: 404

ISBN: 9789928855824

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

**“Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (tetor 1880),
vëllimi V”**



Ky është një nga botimet më të fundit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kjo vepër paraqet një studim origjinal dhe kompleks mbi paradigmen e sistemit emëror të gjuhës shqipe. Me një qasje të gjerë shkencore, autori nuk kufizohet vetëm në paradigmen e fjalëve emërore të veçanta, por analizon dhe shpjegon nga pikëpamja morfologjike dhe sintaksore grupet emërore në rrafsh bashkëkohor dhe historik.

Studimi trajton grupet emërore me dy dhe, më rrallë, me tre përbërës, duke vënë në pah jo vetëm paradigmen e fjalës, por edhe paradigmen e grupit të fjalëve dhe lidhjet sintaksore brenda tij. Botimi përbën një kontribut me vlerë në fushën e gjuhësisë së sotme dhe të gjuhësisë historike shqiptare.

Viti: 2025


Faqe: 194

ISBN: 9789928855282

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Botohet nga Akademia e Shkencave libri “Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (korrik-shtator 1880), vëllimi IV”



“Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (korrik-shtator 1880), vëllimi IV” nga Marenglen Verli dhe Parim Kosova përfshin dokumente të periudhës 1 korrik–30 shtator 1880. Kjo është koha kur mbi Shqipërinë dhe shqiptarët vijnë të shkarkohen të gjitha rrjedhojat negative të Kongresit të Berlinit, përballë të cilave vihet Lidhja Shqiptare.

Dokumentet e këtij vëllimi shpalosin një informacion interesant për sfidat që kaloi Lidhja në muajt e sipërpërmendur për të penguar dhënien e Ulqinit Malit të Zi. Kjo ishte një periudhë tepër e vështirë, e ngarkuar me ankth, indinjatë e revoltë, por edhe një periudhë kur spikati përgjegjësia dhe devocioni për të mobilizuar shqiptarët në mbrojtje të tokave të tyre kundër vendimeve të padrejta të Fuqive të Mëdha.

Materialet e vëllimit lejojnë, po ashtu, të kuptohet qartë natyra komplekse e raporteve brenda vetë Lidhjes, midis Lidhjes dhe shtetit osman, si dhe midis Lidhjes dhe shteteve fqinje.

Viti:2026

Faqe: 596

ISBN: 9789928855893

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

**Botohet nga Akademia e Shkencave “Gjeomorfologjia e Kosovës” me autor
Gjovalin Gruda**



Në këtë vepër, komplekset morfologjike e morfogjenetike të Kosovës janë realizuar në një unitet të plotë me njësitë morfotektonike të kësaj treve, me nivel shkencor bashkëkohor. Strukturimi dhe përmbajtja e kësaj vepre është bërë në përputhje me tematikën tejet të gjerë, duke i krijuar lehtësi lexuesit në kuptimin e plotë të saj.

Autori ka trajtuar zonimin tektonik dhe etapat e evolucionit morfotektonik të njësive strukturore të Kosovës, të cilat janë analizuar në funksion të tematikës së këtij studimi. Një vëmendje të posaçme autori u ka kushtuar karakteristikave të përgjithshme të komplekseve gjenetike të relievit, duke i mbështetur drejtpërdrejt në të dhënat shkencore bashkëkohore të gjeologjisë, gjeomorfologjisë, hidrologjisë, gjeodezisë etj.

Nisur nga këto të dhëna, autori trajton shkencërisht gjendjen e sotme dhe perspektivën e zhvillimit gjeomorfologjik të Kosovës; rëndësinë relievformuese të kushteve morfogjenike të jashtme, si ato klimatike, të rrjetit ujqor, atij akullnajor, karstik, të mbulesës së tokave dhe të bimësisë, të cilat krijojnë njëkohësisht format përkatëse të relievit.

Viti: 2026


Faqe: 724

ISBN: 9789928873019

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

“Aspekte të artizanatit qeramik në territorin e Shqipërisë nga antikiteti në mesjetë”, me autor Eduard Shehi



Ky libër synon të trajtojë më gjerë proceset e prodhimit, të tregtimit e shpërndarjes së prodhimeve qeramike në vendbanimet antike në territorin shqiptar.

Në këtë botim pasqyrohen të detajuara aspektet kryesore të lidhura me studimin qeramik në territorin shqiptar gjatë disa periudhave kohore. Është qartësuar baza mbi të cilën janë ngritur kërkimet në këtë fushë që nga vitet '50 dhe të rejat që sollën arkeologët vendës gjatë disa dhjetëvjeçarëve.

Duke përzgjedhur disa kategori enësh, janë parashtruar tiparet kryesore të shpërndarjes dhe të tregtimit, duke treguar shembuj konkretë të trajtimit të detajuar, me shpresë se në të ardhmen do të shtohen kategori të tjera specifike.

Viti: 2025

Faqe: 545

ISBN: 9789928855312

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

“Mahir Domi, Vepra VII, studime gjuhësore”



-Përgatiti për botim Enver Hysa

Ky libër është vëllimi i shtatë i veprave të profesor Mahir Domit. Ai përmban kryesisht shkrime të botuara për nderim dhe për kujtim të mjeshtërve të gjuhës shqipe, të lëvruesve të hershëm të saj dhe të figurave të shquara të albanologjisë vendëse e të huaj.

Në vëllim përfshihen gjithashtu shkrime me rastin e përvjetorëve të ngjarjeve shkencore, parathënie dhe recensione për vepra të rëndësishme në fushën e shkencave filologjike. Në total, vëllimi përmban rreth 101 shkrime.

Viti: 2025

Faqe: 855

ISBN: 9789928855503

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

“Mahir Domi, Vepra VI, studime gjuhësore”



-Përgatiti për botim Enver Hysa

Ky libër është vëllimi i gjashtë me shkrime të profesor Mahir Domit nga fusha e historisë së gjuhës shqipe dhe e gramatikës historike. Botimi në këtë përmbledhje është i domosdoshëm për hulumtuesit dhe të gjithë të interesuarit rreth gjuhës shqipe dhe historisë së saj.

Vepra ka një përmbajtje të larmishme shkencore e promovuese që plotëson veprimtarinë e gjerë të autorit si studiues në shumë fusha të dijes, si drejtues e udhëheqës shkencor që hapte drejtime e perspektiva të reja në disa fusha të studimeve gjuhësore e filologjike dhe i udhëhiqte ato drejt arritjeve të sigurta.

Vëllimi ka dy pjesë kryesore: I. Dialektologji e Toponomastikë dhe II. Shtojca (artikuj, studime e shkrime të larmishme për shumë fusha të gjuhësisë).

Viti: 2025


Faqe: 487

ISBN: 9789928855480

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Botohet libri “100 vjet teatër në Shkodër (1879-1979)”, me autor Andrea Skanjeti



-Përgatiti për botim: akad.Stefan Çapaliku

Libri "100 vjet teatër në Shkodër: 1879–1979", me autor Andrea Skanjeti, është një vepër monumentale që përmbledh një shekull histori të teatrit në Shkodër, një nga qendrat më të rëndësishme kulturore në Shqipëri.

Autori përfshin një numër të madh aktorësh dhe regjisorësh të njohur nga Shkodra, të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e skenës teatrore në qytet. Ai gjithashtu sjell skena të njohura nga shfaqje të ndryshme dhe ndodhi të rëndësishme kulturore që kanë shënuar rrugëtimin e teatrit në këtë qytet.

Teatri në Shkodër ka një histori të pasur që daton që në fund të shekullit XIX. Qyteti, një qendër kulturore dhe arsimore, u bë vendi ku për herë të parë filluan shfaqjet teatrore në Shqipëri, të mbështetura nga entuziastë lokalë dhe intelektualë që synonin zhvillimin e artit dhe kulturës në një kohë kur Shqipëria ishte ende nën sundimin osman.

Ky botim është një dëshmi e rëndësishme për çdo studiues apo adhurues të historisë së

artit dhe kulturës shqiptare. Ai përfaqëson një përmbledhje të kujtimeve, përvojave dhe ngjarjeve që kanë ndihmuar në formimin e identitetit kulturor të qytetit të Shkodrës dhe të vetë Shqipërisë.

Viti: 2026


Faqe: 320

ISBN: 9789928855961

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Botimet më të reja të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



-“Tufë drite mbi artet” me Josif Papagjoni

Në këtë libër janë përfshirë artikuj të përzgjedhur për teatrin, kinematografinë, letërsinë dhe artet pamore, vepra të realizuara vitet e fundit.

Krahas qasjes kritike dhe një strukture të lehtë sërënditëse, herë-herë janë përfshirë aty edhe qasje teorike për të hedhur dritë në shpjegimin e një fenomeni arti të caktuar, më së shumti kur bëhet fjalë për përditësimin e disa vështirësive estetike dhe proceseve të fundme, që duket se kanë hedhur përsipër velin e një stili, gjuhe dhe semantike të re.

Në libër krijohet një hapësirë e madhe vëllimore e mbushur me tematikë e problematikë të mprehtë estetike dhe artistike, duke sjellë procese e rrjedha të rëndësishme identitare të arteve shqiptare.

Gjuha e pasur është një element që ia vlen të sillet në vëmendje. Ligjërimi i bukur dhe i çlirët e bën të lexueshme dhe një analizë jo të lehtë, duke rizbuluar vlerën estetike të veprave të veçanta, artistët dhe krijuesit e përfshirë në faqet e këtij libri.

Dimensioni i librit është shumë i gjerë, përfshin thuajse krejt artet, gjë që dëshmon interesat e gjera të autorit.

Viti: 2025

Faqe: 603

ISBN: 9789928855213

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

**“Letërsi e vjetër shqipe në kontekst ballkanik dhe evropian (shek. XVI-XVII)”,
nga prof. as. dr. Evalda Paci**



Në këtë vëllim studimor të studiueses Evalda Paci nga Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH, janë ngërthyer çështje të historikut të njohjes së rrethanave të realizimit të veprave më të rëndësishme të letërsisë së vjetër shqipe, të para dhe në kontekst të zhvillimeve përkatëse kulturore në areale të lidhura me kulturën librore dhe, më në veçanti, me atë të shtypshkrimit.

Botimi paraqitet i ndarë në disa kapituj, në të cilët trajtohen me radhë argumente që kanë të bëjnë me censurën librore në vështrim studimor dhe analitik, me reflektimin e saj në periudha që lidhen me zbatimin e dekretëve të Koncilit të Trentit (1545–1563), me përrurimin gjatë shekullit XVII të enteve institucionale botuese që janë reflektuar me rolin përkatës edhe në elementet përfaqësuese të disa veprave të letërsisë së vjetër shqipe.

Çështje të gjurmimit të elementeve të gjeografisë kishtare në këto vepra, të pranisë së elementeve të identitetit kombëtar dhe të ruajtjes së një trashëgimie komplekse përmes përfshirjes në aktet e sinodeve kishtare ceken në pjesë të caktuara të këtij botimi. Janë trajtuar gjithashtu kontribute të përveçme të studiuesve të albanologjisë në lidhje me këtë periudhë të rëndësishme të zhvillimit të kulturës së shkrimit dhe të letërsisë humaniste.

Viti: 2025


Faqe: 459

ISBN: 9789928855930

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Botohet partitura e simfonisë “Albanoi” e kompozitorit Vasil S.Tole



Shoqata Titulli “Albanoi” është referencë historike për përmendjen më të hershme të fjalës “Albanoi”, që më pas u zhvillua në “Arbër”, “Shqiptarët”, një simbolikë e rrënjëve tona të hershme.

Simfonia përbëhet nga katër kohë: Eposi, Isoja, Prechorus Dance dhe Revelry Finale, të disenjuara për të përfaqësuar karakteristikat muzikore të kulturës shqiptare, të përpunuara në një gjuhë bashkëkohore muzikore.

Çdo kohë e veprës i është dedikuar një figure influencuese në jetën apo karrierën e Toles: Eposi i është dedikuar Ismail Kadare.

Isoja i është dedikuar Wolfgang Hufschmidt.

Prechorus Dance i është dedikuar Eno Koço.

Heng/Revelry Finale i është dedikuar Çesk Zadeja.

Viti: 2025

Faqe: 243

ISMN: 9790902160575

Interpretimin e simfonisë “Albanoi” nga orkestra simfonike e RTSH, dirigjent Eno Koço e ndiqni në këtë link: <https://youtu.be/QvYXTQYI-GM?si=4L5HZnG1AP6NZvxL>

Botohet libri “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe IV”



-Përgatitën për botim: prof. asoc. Adelina Çerpja, akad. Valter Memisha, prof. dr. Artur Lama

Ky libër botohet pas një ndërprerjeje të gjatë dhe është tregues i vazhdimësisë së interesit shkencor për disa prej fushave më të rëndësishme të kërkimit gjuhësor brenda hapësirës shqiptare dhe më gjerë.

Botimi i këtij vëllimi pas më shumë se 30 vjetësh merr një domethënie të veçantë, pasi nuk përfaqëson thjesht një vijim kronologjik të një pune të nisur më parë, por edhe një rimarrje të diskutimeve shkencore në një kontekst të ri, të shënuar nga ndryshime të thella në jetën shoqërore dhe kulturore të shqiptarëve, në hapësirat ku shqipja përdoret e zhvillohet, si dhe në mënyrat e qasjes kërkimore ndaj dukurive gjuhësore.

Viti: 2026


Faqe: 472

ISBN: 9789928855879

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

“Pesha e fjalës shqipe” nga akad. Gjovalin Shkurtaj



Në këtë botim janë përfshirë pjesë të zgjedhura nga kërkimet dhe studimet e autorit rreth onomastikës shqiptare. Libri është mirëfilli leksikologji e leksikografi historike, me vlerë të veçantë për historinë e gjuhës shqipe e të fjalës shqipe, një burim i rëndësishëm informimi edhe për të tjerë.

Lexuesi më i ditur, por edhe ai më pak i ditur mund t'i hetojë shembujt e këtushëm (tek toponimet ka edhe leksik konkret, sidomos nga fusha e bujqësisë, blegtorisë, jetës familjare, gjeografisë topografike etj).

Në tërësinë e tij, veç studimor, libri është një fjalor i mirëfilltë toponimik i gjuhës shqipe dhe zë një vend me peshë në leksikografinë onomastike.

Viti: 2026

Faqe: 720


ISBN: 9789928855787

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Të tjera

Prof. dr. Fjoralba Cakoni, anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mban ligjëratën “Sonia Kovalevsky” në SIAM 2026



Prof. Dr. Fjoralba Cakoni, anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, është fituese e ligjëratës prestigjioze “Sonia Kovalevsky” dhe do ta mbajë më 7 korrik 2026, ora 14:00, në Cleveland, Ohio, SHBA, gjatë Takimit Vjetor të Shoqatës për Matematikën Industriale dhe të Aplikuar (SIAM). (Për më shumë, lexoni linkun: <https://www.facebook.com/61553652170380/posts/122247587636121739/?mibextid=wwXIfr&rdid=0aWhUPfQQJnPUegL>).

Ky vlerësim jepet çdo vit nga Shoqata për Gratë në Matematikë (AWM) dhe SIAM për të nxjerrë në pah kontributet e rëndësishme të grave në matematikën e aplikuar dhe kompjuterike.

Ligjërata e saj, me titull “Spectral Problems in Inverse Scattering” (Problemet spektrale në teorinë e shpërndarjes së valëve”) trajton kërkimet në teorinë e shpërndarjes së kundërt, një fushë ku prof. dr. Cakoni ka dhënë kontribute të rëndësishme shkencore, duke sjellë një ndryshim paradigme në metodat e rikonstruksionit dhe aplikimet e tyre në teknologji moderne.

Prof. dr. Fjoralba Cakoni është profesoreshë e dalluar e Matematikës në Universitetin Rutgers, SHBA. Ajo është anëtare e Shoqatës Amerikane të Matematikës (AMS), e Shoqatës për Matematikën Industriale dhe të Aplikuar (SIAM), autore dhe bashkautore e më shumë se 120 artikujve shkencorë dhe tre monografive. Si anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtare e Institutit Kombëtar të Matematikës, ajo vijon të kontribuojë në promovimin e matematikës dhe në mbështetjen e brezit të ri të studiuesve shqiptarë.

Më 28 korrik 1922, Shqipëria u njoh zyrtarisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nisi marrëdhëniet diplomatike



Akademia e Shkencave e Shqipërisë kujton sot një moment historik të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit: njohjen zyrtare të Shqipërisë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në vitin 1922.

Ky akt ndodhi vetëm pak vite pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912, duke shënuar një hap vendimtar për konsolidimin e shtetit të ri shqiptar në arenën ndërkombëtare. Njohja nga SHBA-të përfaqësonte një mbështetje të fuqishme për sovranitetin e vendit dhe një garanci për rrugëtimin e tij drejt afirmimit ndërkombëtar. Në dhjetor të vitit 1922, ambasadori i parë amerikan në Shqipëri, Grant-Smith, nisi punën e tij në Tiranë, duke vendosur themelet e marrëdhënieve diplomatike shqiptaro-amerikane.

Ky moment u bë simbol i miqësisë dhe partneritetit strategjik që do të zhvillohej më tej ndërmjet dy vendeve, duke shënuar një kthesë të madhe në historinë e shtetit shqiptar, duke hapur një kapitull të ri të bashkëpunimit politik, ekonomik dhe kulturor me një nga fuqitë më të mëdha botërore.

Që prej asaj kohe, marrëdhëniet shqiptaro-amerikane kanë qenë të mbështetura mbi vlera të përbashkëta të lirisë dhe demokracisë, duke kontribuar në forcimin e shtetit shqiptar dhe integrimin e tij në botën demokratike.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë nderon sot kujtimin e këtij akti historik, duke vlerësuar rëndësinë e tij për rrugëtimin e vendit drejt konsolidimit shtetëror dhe integritetit ndërkombëtar.

Gjirokastra në UNESCO: 21 vjet pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore



Gjirokastra, qyteti ku është derdhur arti i ndërtimeve të gurta, u bë pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, më 15 korrik të vitit 2005 duke u njohur ndërkombëtarisht si një nga qendrat më të veçanta historike dhe kulturore të Ballkanit. Ky moment i rëndësishëm erdhi pas një procesi të gjatë dokumentimi dhe vlerësimi, ku institucionet shqiptare, ekspertët e trashëgimisë dhe komuniteti lokal bashkëpunuan për të dëshmuar vlerat e jashtëzakonshme të qytetit.

Pranimi i Gjirokastrës në UNESCO u mbështet nga studimet e historianëve dhe arkitektëve, nga përkushtimi i Ministrisë së Kulturës dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës, si dhe nga vetë banorët që kanë ruajtur me kujdes shtëpitë karakteristike me kulla, pazarin e vjetër, xhaminë e shekullit XVIII dhe kishat e periudhës osmane.

Kjo trashëgimi e gjallë, e pasqyruar në rrugicat e kalldrëmta dhe në citadelën e shekullit XIII, është një dëshmi e mënyrës së jetesës qytetare dhe e arkitekturës osmane të ruajtur në mënyrë të rrallë.

Përfshirja e Gjirokastrës në UNESCO është një arritje e madhe për Shqipërinë, por edhe një përgjegjësi e madhe për ruajtjen e autenticitetit të qytetit, mbrojtjen e peizazhit historik nga ndërhyrjet e pakontrolluara dhe sigurinë që brezat e ardhshëm ta trashëgojnë këtë pasuri të rrallë.

Gjirokastra nuk është vetëm një qytet-muze, por një simbol i identitetit kulturor shqiptar, një thesar që na lidh me historinë dhe që na vendos më fuqishëm në hartën kulturore të botës.

Berati, dëshmi e qytetërimit dhe e trashëgimisë kulturore



Më 8 korrik 2008, qyteti historik i Beratit u përfshi në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, duke marrë një nga vlerësimet më të larta ndërkombëtare për rëndësinë e tij të jashtëzakonshme kulturore dhe historike.

Berati, i njohur si "Qyteti i një mbi një dritareve", përfaqëson një nga qendrat më të rëndësishme të qytetërimit në hapësirën shqiptare. Gjurmët e banimit në këtë territor datojnë që në Epokën e Bronzit, ndërsa në fund të shekullit IV para erës sonë ai u zhvillua si qytet-kështjellë me emrin Antipatrea. Gjatë periudhës romake, rëndësia e tij strategjike e shndërroi në një nga fortesat kryesore të rajonit.

Në vitin 1961, Berati u shpall qytet-muze, si dëshmi e vlerave të tij të spikatura historike, arkitekturore dhe kulturore. Qyteti ruan një ansambël të pasur monumentesh, ku spikasin Kalaja e Beratit, lagjet historike, kishat e periudhës bizantine, monumentet e kultit, Ura e Goricës dhe tradita e pasur e zejeve, të cilat dëshmojnë vazhdimësinë e jetës urbane dhe të kulturës shqiptare ndër shekuj.

Përfshirja e Beratit në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s përfaqëson njohjen ndërkombëtare të një peizazhi kulturor unik, ku arkitektura, historia dhe traditat materiale e shpirtërore ndërthuren në mënyrë të pandashme. Ky status vlerëson autenticitetin dhe integritetin e qytetit, duke e renditur atë ndër pasuritë më të çmuara të trashëgimisë kulturore botërore.

Në këtë përvjetor, Akademia e Shkencave e Shqipërisë vlerëson pasuritë e jashtëzakonshme historike, kulturore dhe arkitekturore të Beratit, një prej dëshmimeve më përfaqësuese të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Kujtojmë ditën e themelimit të Klubit “Bashkimi” të Manastirit



Klubi “Bashkimi” u themelua në Manastir më 31 korrik 1908 nga atdhetarët Fehim Zavalani dhe Gjergj Qiriaz, në një kohë kur shqiptarët po përballeshin me sfida të mëdha për ruajtjen e gjuhës dhe kulturës së tyre kombëtare brenda Perandorisë Osmane.

Themeluesit e tij, të frymëzuar nga ideali i Rilindjes Kombëtare, e ngritën këtë klub si një qendër të mendimit dhe veprimit patriotik, ku u mbledhën intelektualë, veprimtarë dhe përfaqësues të shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare. Qëllimi i tij ishte i qartë: përhapja e gjuhës shqipe, hapja e shkollave kombëtare, botimi i librave dhe gazetave në shqip, si dhe organizimi i mbledhjeve e aktiviteteve që do të forconin ndërgjegjen kombëtare.

Anëtarët e klubit përbëheshin nga figura të shquara të kohës, përfshirë mësues, shkrimtarë dhe aktivistë kombëtarë si Mit’hat Frashëri, Bajo Topulli, Shahin Kolonja dhe të tjerë. Përpjekjet e tyre përmes Klubit Shqiptar të Manastirit ndikuan jo vetëm në edukimin dhe kultivimin e kulturës kombëtare, por edhe në krijimin e një platforme politike për autonominë dhe të drejtat e shqiptarëve. Në këtë vatër u kristalizua ideja e bashkimit shpirtëror dhe kulturor të shqiptarëve, duke u bërë një forum i gjallë ku u

diskutuan çështje të arsimit, të gjuhës dhe të politikës kombëtare.

Pikërisht në këtë klub u hodhën hapat për organizimin e Kongresit të Manastirit, që u mbajt në nëntor të vitit 1908, ku u vendos alfabeti i unifikuar i gjuhës shqipe, një vendim historik që i dha kombit tonë një bazë të përbashkët për arsimin dhe kulturën.

Klubi “Bashkimi” nuk ishte thjesht një organizatë lokale, por një simbol i përpjekjes së shqiptarëve për të dalë nga errësira e mohimit dhe për të ndërtuar themelet e një shteti të lirë. Ky klub, mbeti një pikë referimi e Rilindjes Kombëtare, duke përgatitur terrenin për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912 dhe duke lënë një trashëgimi të vyer në historinë tonë kombëtare, që sot e kujtojmë me nderim si një ditë themeli të vetëdijes sonë kombëtare.

Klubi “Bashkimi” nuk ishte thjesht një organizatë lokale, por një simbol i përpjekjes së shqiptarëve për të dalë nga errësira e mohimit dhe për të ndërtuar themelet e një shteti të lirë.

Gjithashtu, ky klub përgatiti terrenin për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912. Me rënien e Perandorisë Osmane dhe ndryshimet gjeopolitike në Ballkan, aktivitetet e klubit ranë, por trashëgimia e tij mbeti si një pikë referimi për lëvizjet kombëtare dhe kulturore shqiptar, duke lënë një trashëgimi të vyer në historinë tonë kombëtare.

Më 10 korrik 1952 u ngrit Kinostudioja “Shqipëria e Re”, themeli i kinematografisë shqiptare



Kinostudioja “Shqipëria e Re”, qendra e parë e industrisë së filmit shqiptar, u përrua me 10 korrik 1952, duke i dhënë Shqipërisë mundësinë që të krijonte kinemanë e saj kombëtare.

Godina monumentale, e ngritur me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, u ndërtua sipas modelit neoklasik, dhe u bë shpejt simbol i artit të shtatë në vendin tonë.

Kinostudioja solli teknologji moderne për kohën, ekspertizë profesionale, duke filluar me realizimin e filmit të parë të realizuar në bashkëpunim, “Skënderbeu” (1953). Gjithashtu ky film shënoi hyrjen e kinemasë shqiptare në skenën ndërkombëtare.

Vetëm pak vite më vonë, me filmin “Tana” (1958), kineastët shqiptarë arritën të prodhonin krejtësisht një film artistik me metrazh të gjatë, duke vendosur bazat e prodhimit vendas. Që prej asaj kohe, Kinostudioja u bë vatër e krijimtarisë filmike, ku u realizuan qindra filma artistikë, dokumentarë dhe të animuar, duke pasqyruar jetën, historinë dhe aspiratat e shoqërisë shqiptare.

Në dekadat që pasuan, Kinostudioja “Shqipëria e Re” u shndërrua në një institucion të rëndësishëm kulturor, ku punuan emra të shquar të kinemasë si: Hysen Hakani, Kristaq Dhamo, Endri dhe Xhanfise Keko, Dhimitër Anagnosti, Viktor Gjika, Kujtim Çashku,

Rikard Ljarja, Gëzim Erebara, Muharrem Fejzo, Piro Milkani, Esat Musliu, Saimir Kumbaro, Ibrahim Muça, Kristaq Mitro, Gëzim Çela, Ilia Tërpini, Vladimir Prifti, e shumë të tjerë.

Secili prej tyre solli një vizion të veçantë, duke e pasuruar gjuhën filmike shqiptare dhe duke e bërë Kinostudion një akademi të vërtetë për edukimin e brezave të rinj të kineastëve.

Në vitet '80, prodhimi arriti kulmin, me mbi një duzinë filmash në vit, duke e bërë kinemanë shqiptare një pjesë të pandashme të kujtesës kolektive.

Përveç regjisorëve dhe kineastëve që formësuan gjuhën filmike shqiptare, Kinostudioja "Shqipëria e Re" u bë edhe skena ku u rritën dhe u afirmuan aktorët më të shquar të teatrit dhe filmit shqiptar si: Tinka Kurti, Margarita Xhepa, Naim Frashëri, Kadri Roshi, Sandër Prosi, Violeta Manushi, Llazi Sërbo, Drita Pelling, Roza Anagnosti, Besa Imami, Pirro dhe Pavlina Mani, Prokop Mima, Agim Qirjaqi, Ndreka Luca, Justina Aliaj, Dhimitër Orgocka, Marjeta Ljarja, Mirush Kabashi, Timo Flloko, Reshat Arbana, Sulejman Pitarka, Yllka Mujo, Hajrie Rondo, Sandër Lako, Ndriçim Xhepa, Kristaq Skrami, Elvira Diamnati, Bujar Lako, Mevlan Shanaj, Luiza Xhuvani, Rajmonda Bulku dhe shumë të tjerë. Ata u dhanë jetë personazheve të paharrueshëm, duke krijuar një galeri karakteresh që mbeten të rrënjosura në kujtesën e publikut dhe shndërruan Kinostudion në një akademi të vërtetë të artit të aktrimit dhe në një institucion që edukoi breza të tërë aktorësh.

Pas viteve '90, Kinostudioja u transformua në "Albafilm", ndërsa më 1996 trashëgimia e saj kaloi tek Qendra Kombëtare e Kinematografisë. Sot, godina historike strehon institucione të kulturës dhe mbetet një pikë referimi për historinë e artit shqiptar.

Akademia e Shkencave, në ditën e themelimit vlerëson rolin e pazëvendësueshëm të trashëgimisë kinematografike të Kinostudios Shqipëria e re, nëpërmjet së cilës ruhen kujtimet e një epoke, dokumentohen zhvillimet e shoqërisë dhe janë mbartur vlerat e një arti që, pavarësisht kufizimeve ideologjike, arriti të krijojë identitetin e vet.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë urime për akademikë dhe personalitete në muajin korrik

Gjatë muajit korrik, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka përcjellë urimet e saj me rastin e ditëlindjeve të akademikëve dhe të personaliteteve të shquara të artit, shkencës dhe kulturës, të cilët përmes veprimtarisë së tyre krijuese e shkencore kanë dhënë kontribut të çmuar në pasurimin e jetës akademike dhe kulturore shqiptare.

Në këtë kuadër, Akademia e Shkencave i shprehu urimet e saj Ermonela Jahos, sopranos me famë botërore dhe anëtares së jashtme të Akademisë së Shkencave, duke vlerësuar kontributin e saj të jashtëzakonshëm në artin operistik dhe rolin e saj në promovimin e vlerave të kulturës shqiptare në skenat ndërkombëtare.

Urime të veçanta iu kushtuan edhe akademikut Adrian Civici, për kontributin e tij të rëndësishëm në fushën e ekonomisë, të kërkimit dhe të mendimit shkencor, si dhe akademikut Emin Riza, studiuesit të shquar të trashëgimisë kulturore dhe arkitekturës shqiptare, për veprën e tij të gjerë shkencore në studimin, dokumentimin dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kombëtare.

Përmes këtyre vlerësimeve, Akademia e Shkencave e Shqipërisë vijon të nderojë personalitetet që me veprën dhe arritjet e tyre përfaqësojnë kontribute të rëndësishme në zhvillimin e shkencës, artit dhe kulturës shqiptare.

Podcast

Podcast AKADEMIA 3: Intervistë me akad. Ilia Mikerezin



Në episodin e tretë të “Podcast Akademia” është i ftuar akad. Ilia Mikerezi, drejtues shkencor i Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Diskutimi u fokusua tek ADN-ja si bazë e trashëgimisë gjenetike dhe në gjenetikën e popullatave, duke theksuar rolin e saj në kuptimin e variacionit biologjik.

U trajtuan gjithashtu funksionimi dhe roli i Qendrës së Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, sfidat e kërkimit shkencor në Shqipëri, si dhe rëndësia e bashkëpunimeve ndërkombëtare për avancimin e studimeve në fushën e gjenetikës.

Për më shumë shikoni linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=7a00s4cXvZc>



Podcast AKADEMIA 4: Intervistë me akademik Rrapo Ormëni



Në episodin e katërt ndalemi te vepra “Akademik Eduard Sulstarova -Vepra të zgjedhura në fushën e sizmologjisë”, një botim që sjell në vëmendje figurën, veprimtarinë dhe kontributin e një prej studiuesve më të rëndësishëm të sizmologjisë shqiptare.

I ftuar në këtë episod është akademik Rrapo Ormëni, një nga figurat më të njohura të gjeologjisë shqiptare, me një kontribut të çmuar në fushën e studimeve gjeologjike e sizmologjike, si edhe në jetën akademike dhe institucionale të vendit.

Gjatë intervistës, akademik Ormëni ndan vlerësimet dhe këndvështrimet mbi trashëgiminë shkencore të akademik Eduard Sulstarovës, rëndësinë e studimeve sizmologjike në zhvillimin e shkencës shqiptare, si dhe vlerën që ky botim përfaqëson për studiuesit dhe brezat e rinj të kërkuesve shkencorë.

Për më shumë shikoni linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=QftTRhucfc8>



Podcast AKADEMIA 5: Intervistë me akademik Besnik Baraj dhe prof. dr. Melissa J. Perry



Në episodin e pestë të Podcast Akademia, akad. Besnik Baraj dhe prof. dr. Melissa J. Perry paraqesin përfundimet kryesore të Konferencës së 4-t Ndërkombëtare për Shëndetin Publik dhe Mjedisin, organizuar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Ata ndajnë me publikun përfundimet kryesore të konferencës, duke u ndalur te rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në kërkimin shkencor, si dhe te sfidat bashkëkohore që lidhen me shëndetin publik, ndotjen e mjedisit, ndryshimet klimatike dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në kërkimin mjedisor.

Për më shumë shikoni linkun: <https://youtu.be/4FGJVypJ9zw>



Podcast AKADEMIA 6: Intervistë me akademik Gëzim Hoxha



Në episodin e gjashtë të "Podcast Akademia", i ftuar është akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe Kryeredaktor i revistës shkencore "Studia Albanica".

Biseda fokusohet në historinë, misionin dhe rolin e "Studia Albanica" në zhvillimin e studimeve albanologjike. Gjatë episodit diskutohen standardet e botimit shkencor, sfidat e botimeve akademike në epokën digjitale dhe rëndësia e përfshirjes së studiuesve të rinj në kërkimin shkencor.

Për më shumë shikoni linkun: <https://youtu.be/Duw7U-B7iPg>



Podcast AKADEMIA 7: Intervistë me akademik Shaban Sinani



Në episodin e shtatë të “Podcast Akademia”, i ftuar është akad. Shaban Sinani, drejtues i redaksisë vendore Tiranë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në këtë bisedë, akad. Sinani sjell një vështrim mbi zhvillimin e enciklopedizmit shqiptar, rrugëtimin drejt hartimit të “Enciklopedisë Shqiptare” dhe rëndësinë e këtij projekti për studimet albanologjike.

Ai ndalet te sfidat shkencore dhe metodologjike të një vepre madhore që synon të pasqyrojë dijen, kulturën dhe trashëgiminë shqiptare.

Për më shumë shikoni linkun: <https://youtu.be/Lequb8eAro0>



In Memoriam

Ndahet nga jeta akademik Emin Riza, studiuesi i shquar i trashëgimisë kulturore



-Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë mesazh ngushëllimi për humbjen e akademikut Emin Riza

Është ndarë nga jeta në moshën 89-vjeçare akademik Emin Riza, një nga studiuesit më të njohur shqiptarë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe arkitekturës tradicionale.

Ai lindi më 3 korrik 1937 në Shkodër. Me një karrierë të gjatë si studiues, pedagog dhe specialist në Institutin e Monumenteve të Kulturës, akad. Riza ka dhënë një kontribut të spikatur në dokumentimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë materiale shqiptare.

Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë "Qyteti-Muze i Gjirokastrës" (1980), një studim themelor mbi trashëgiminë ndërtimore të Gjirokastrës, banesat karakteristike dhe vlerat e saj si qytet-muze, si edhe "Banesa shqiptare me qoshk" (2018), monografi e botuar nga Akademia e Shkencave, e cila trajton tipologjinë e banesave popullore shqiptare me qoshk dhe vlerat e tyre arkitektonike.

Akademik Riza ishte autor i 16 monografive, pesë prej tyre në bashkautorësi, si edhe i 134 artikujve shkencorë të botuar në revista të specializuara, ndër to "Studia Albanica",

"Arkitektura popullore shqiptare" dhe "Monumentet", ku trajtoi tipologjitë e banesave popullore, strukturat ndërtimore dhe trashëgiminë e qyteteve historike.


Ai ishte gjithashtu kryeredaktor i revistave "Studia Albanica" dhe "Monumentet", duke nxitur botimin e studimeve mbi trashëgiminë kulturore shqiptare. Akademik Riza ishte nismëtar i Ligjit "Për trashëgiminë kulturore" dhe kryesues i grupit të punës për përgatitjen e dosjeve të Gjirokastrës dhe Beratit për UNESCO-n, ç'ka kontribuo në përfshirjen e këtyre qyteteve në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, akademik Emin Riza u nderua me titullin "Qytetar Nderi" i Gjirokastrës dhe i Beratit. Ai ishte gjithashtu anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, një vlerësim i rëndësishëm i autoritetit të tij shkencor në mbarë hapësirën shqiptare.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Komisioni i Përhershëm i Trashëgimisë Kulturore i shprehin familjes, miqve, komunitetit akademik dhe bashkëpunëtorëve ndër vite të akademik Emin Rizës ngushëllimet më të sinqerta për këtë humbje të madhe njerëzore dhe shkencore.

Homazhet do të mbahen sot në ambientet e agjencisë funerale Alba 2000, pranë Medresesë. Ceremonia e përcjelljes për në banesën e fundit do të zhvillohet në orën 16:00, në varrezat e Tufinës.

Fjala e akademik Gëzim Hoxhës në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në ceremoninë e lamtumirës së akademikut Emin Riza



Në ceremoninë e përcjelljes për në banesën e fundit të akademikut Emin Riza, në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, fjalën e lamtumirës e mbajti Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akademik Gëzim Hoxha.

Në fjalën e tij ai shprehu ngushëllimet më të sinqerta për familjen dhe vlerësoi jetën, veprën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të akademikut Emin Riza në zhvillimin e shkencës shqiptare dhe në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Më poshtë fjala e plotë e akademik Gëzim Hoxha:

E nderuar familje Riza,

Të nderuar kolegë akademikë,

Të nderuar miq, bashkëpunëtorë dhe pjesëmarrës,

Sot jemi mbledhur me dhimbje të thellë për t'i dhënë lamtumirën e fundit një prej personaliteteve më të shquara të shkencës shqiptare, akademikut Emin Riza.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dëshiroj t'i shpreh familjes së tij, të afërmeve, miqve dhe gjithë komunitetit shkencor ngushëllimet tona më të sinqerta.

Me ndarjen nga jeta të akademik Emin Rizës, Shqipëria humbet një studiues të rrallë, një

mbrojtës të palodhur të trashëgimisë sonë kulturore dhe një qytetar të përkushtuar, i cili ia kushtoi gjithë jetën ruajtjes së kujtesës historike të kombit.

Në këtë ditë të rëndë, mendimet tona janë para së gjithash pranë familjes së akademik Emin Rizës. Humbja e një babai, gjyshi e njeriu të dashur është një dhimbje që nuk mund të lehtësohet me fjalë... Akademia e Shkencave e Shqipërisë do ta ruajë me nderim kujtimin e tij dhe do të mbetet gjithmonë pranë familjes së tij me respekt e mirënjohje.

Për më shumë se gjashtë dekada, ai punoi me një pasion të jashtëzakonshëm për të njohur, dokumentuar, restauruar dhe mbrojtur arkitekturën tradicionale shqiptare. Ai nuk studioi vetëm ndërtesa. Ai studioi jetën që ato mbartnin, kulturën që ato përfaqësonin dhe identitetin që ato përcillnin brez pas brezi.

Veprat e tij shkencore, të cilat përfshijnë monografi themelore për qytetet historike shqiptare, për banesën popullore dhe teorinë e restaurimit, do të mbeten për shumë kohë pika referimi për studiuesit, arkitektët dhe restauruesit. Ato dëshmojnë një kulturë të gjerë shkencore, një metodë kërkimore të rreptë dhe një përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj së vërtetës shkencore.

Kontributi i akademik Rizës nuk mbeti vetëm në libra. Ai u mishërua në vetë monumentet që sot vazhdojnë të jetojnë. Falë punës së tij dhe të bashkëpunëtorëve të tij, qytete si Gjirokastra dhe Berat jo vetëm u ruajtën me kujdes shkencor, por fituan edhe vlerësimin më të lartë ndërkombëtar, duke u bërë pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Ky është një kontribut që e tejkalon kohën dhe do të mbetet përgjithmonë pjesë e historisë së kulturës shqiptare.

Brenda Akademisë së Shkencave, akademik Emin Riza la gjurmë të rëndësishme edhe si kryetar seksioni, si sekretar shkencor, si kryeredaktor i revistës Studia Albanica dhe si akademik, duke qenë gjithmonë një zë i urtë, i matur dhe i respektuar. Ai i përkiste atij brezi studiuesish që e shihnin dijen si shërbim ndaj shoqërisë dhe institucionin si përgjegjësi morale.

Për të gjithë ne që patëm fatin ta njohim nga afër, ai do të kujtohet jo vetëm për autoritetin e tij shkencor, por edhe për thjeshtësinë, fisnikërinë, korrektësinë dhe qytetarinë e tij. Ishte një njeri që fitonte respekt jo me zhurmë, por me punë; jo me fjalë të mëdha, por me shembullin e tij.

Jeta e akademik Emin Rizës është dëshmi se trashëgimia nuk mbrohet vetëm me ligje dhe institucione; ajo mbrohet mbi të gjitha nga njerëzit që e duan, e njohin dhe ia kushtojnë jetën asaj. Ai ishte një prej këtyre njerëzve të rrallë.

Sot ndahemi fizikisht prej tij, por vepra e tij do të vazhdojë të jetojë në qytetet që ai ndihmoi të ruhen, në monumentet që ai shpëtoi, në librat që ai shkroi, tek studentët e studiuesit që ai frymëzoi dhe në ndërgjegjen kulturore të kombit shqiptar.

Ndërsa e përcjellim në banesën e fundit, nuk ndahemi vetëm nga një akademik i shquar. Ndahemi nga një njeri që i dha zë gurit, kujtesës dhe historisë së këtij vendi. Për këtë,

brezat do t'i jenë përherë mirënjohës." Në këto çaste lamtumire, Akademia e Shkencave e Shqipërisë perkulet me respekt dhe mirënjohje të thellë përpara jetës dhe veprës së tij. Në këtë lamtumirë të fundit për akademiun Emin Riza, shprehim mirënjohjen tonë të thellë për gjithçka, që i ka dhënë shkencës shqiptare, kulturës sonë kombëtare dhe brezave që do të vijjnë.

Pushoftë në paqe!

Qoftë i përjetshëm kujtimi dhe vepra tij!

Telegram ngushëllimi nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës për ndarjen nga jeta të akademik Emin Riza



NDAHET NGA JETA AKADEMIK EMIN RIZA

Sot morëm kumtin e zi për ndarjen nga jeta të intelektualit, studiuesit të shquar të trashëgimisë kulturore, në mënyrë të veçantë të arkitekturës popullore shqiptare, veprimtarit të jashtëzakonshëm në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore akademik Emin Riza, anëtar emeritus i ASHSH-së dhe anëtar i jashtëm i ASHAK-ut.

I lindur në Korçë më 1937, i biri i gjuhëtarit të shquar Selman Riza nga Gjakova, Emin Riza shkollimin e rregullt fillor dhe të mesëm i bëri në Tiranë. Studimet e larta i mbaroi në Degën e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Tiranës, ku u diplomua në 1962. Gjatë gjithë jetës së tij të punës veproi në Institutin e Monumenteve. Në vitet 1993-1997 ka qenë Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akademik Emin Riza në gjithë shekullin e tij të punës ka vepruar në fushën e restaurimit, të mbrojtjes e rivitalizimit të arkitekturës tradicionale në të gjitha hapësirat shqiptare, duke u bërë kështu një nga emrat më të shquar të kësaj fushe studimesh. Botoi qindra artikuj studimorë brenda vendit dhe nëpër revistat e specializuara ndërkombëtare. I shquar në punën e tij studimore, ishte kryeredaktor i revistës së specializuar *Monumentet*, ndërsa për një kohë dhe kryeredaktor i *Studia albanica*. Ishte specializuar sidomos në fushën e restaurimit dhe studimit të arkitekturës së qyteteve, për çka shkroi një duzinë monografish, ndër të cilat shquhen studimet e tij për arkitekturën tradicionale të Tiranës, të Beratit, të Shkodrës, të Korçës, të Kosovës, të Gjakovës, të Prizrenit, të Gjirokastrës, të Krujës, etj. Ishte nismëtar i hartimit të Ligjit për trashëgiminë kulturore në Shqipëri, e pastaj edhe në Kosovë, ku veproi për një kohë pas çlirimit.

Angazhime të veçanta ka shfaqur në punën e grupit që bëri gati dosjen e UNESCO-s për Gjirokastrën dhe Beratin. Ka bërë emër ndërkombëtarisht të njohur në fushën e studimit dhe restaurimit të monumenteve në hapësirat shqiptare dhe në përgjithësi, për çka veproi gjatë si ekspert i njohur i UNESCO-s.

Faqe 1 nga 2

Sot morëm kumtin e zi për ndarjen nga jeta të intelektualit, studiuesit të shquar të trashëgimisë kulturore, në mënyrë të veçantë të arkitekturës popullore shqiptare, veprimtarit të jashtëzakonshëm në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore akademik Emin Riza, anëtar emeritus i ASHSH-së dhe anëtar i jashtëm i ASHAK-ut. I lindur në Korçë më 1937, i biri i gjuhëtarit të shquar Selman Riza nga Gjakova, akad. Emin Riza shkollimin e rregullt fillor dhe të mesëm i bëri në Tiranë.

Studimet e larta i mbaroi në Degën e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Tiranës, ku u diplomua në 1962. Gjatë gjithë jetës së tij të punës veproi në Institutin e Monumenteve. Në vitet 1993-1997 ka qenë Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Akademik Emin Riza në gjithë shekullin e tij të punës ka vepruar në fushën e restaurimit, të mbrojtjes e rivitalizimit të arkitekturës tradicionale në të gjitha hapësirat shqiptare, duke u bërë kështu një nga emrat më të shquar të kësaj fushe studimesh. Botoi qindra artikuj studimorë brenda vendit dhe nëpër revistat e specializuara

ndërkombëtare. I shquar në punën e tij studimore, ishte kryeredaktor i revistës së specializuar Monumentet, ndërsa për një kohë dhe kryeredaktor i Studia Albanica.

Ishte specializuar sidomos në fushën e restaurimit dhe studimit të arkitekturës së qyteteve, për çka shkroi një duzinë monografish, ndër të cilat shquhen studimet e tij për arkitekturën tradicionale të Tiranës, të Beratit, të Shkodrës, të Korçës, të Kosovës, të Gjakovës, të Prizrenit, të Gjirokastrës, të Krujës, etj. Ishte nismëtar i hartimit të Ligjit për trashëgiminë kulturore në Shqipëri, e pastaj edhe në Kosovë, ku veproi për një kohë pas çlirimit. Angazhime të veçanta ka shfaqur në punën e grupit që bëri gati dosjen e UNESCO-s për Gjirokastrën dhe Beratin.

Ka bërë emër ndërkombëtarisht të njohur në fushën e studimit dhe restaurimit të monumenteve në hapësirat shqiptare dhe në përgjithësi, për çka veproi gjatë si ekspert i njohur i UNESCO-s. Në Kosovë ka lënë dy vepra me vlerë të madhe shkencore, monografinë Banesa qytetare kosovare e shek. XVIII-XIX, ASHAK 2006, bashkë me Njazi Halitin dhe Arkitektura popullore e Gjakovës, ASHAK 2017. Monografite e tij të shumta për arkitekturën e qyteteve shqiptare janë punuar me metodologji e mbështetje në kritere e prosede rigoroze shkencore.

Monumentet, arkitekturën e qyteteve dhe arkitekturën popullore akad. Emin Riza i vështronte në një kontekst më të gjerë funksional në raport me rrethanat shoqërore të kohës kur janë krijuar. Për merita të jashtëzakonshme në fushën e studimit, të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore shqiptare akademik Emin Riza u nderua me titullin “Qytetar nderi” i Gjirokastrës dhe “Qytetar nderi” i Beratit. Akademik Emin Riza është shquar si personalitet posaçërisht bashkëpunues dhe i afërt me kolegë e studentë dhe ka qenë aktiv në fushën e organizimeve të veprimtarive shkencore, ndër të cilat dhe i Konferencës për Kosovën në Tiranë më 1993. Vepra e tij shkencore ka shënuar një shkallë të lartë të arritjeve të shkencës shqiptare në këto fusha. Kujtimin për të do ta kenë të përjetshëm brezat me të cilat punoi.

Anëtarëve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, kolegëve dhe familjes u shprehim ngushëllime.

Kryetarja e ASHAK-ut akademike Justina Shiroka-Pula

Ndahet nga jeta studiuesi i letërsisë shqipe Ali Xhiku



Është ndarë nga jeta në moshën 83-vjeçare pedagogu dhe studiuesi i letërsisë shqipe, Ali Xhiku, duke lënë pas një trashëgimi të pasur në fushën e kritikës dhe historiografisë letrare. Për dekada ai shërbeu me përkushtim në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, ku mbajti edhe detyrat e zv/dekanit dhe më pas të dekanit, duke formuar breza studentësh dhe duke ndikuar në mënyrën se si u lexua dhe u interpretua letërsia shqipe. Vitin e kaluar, profesori ishte nderuar me çmimin “Autori i librit më të mirë studimor” në Panairin e 28-të të Librit për veprën “Faqeve të historiografisë shqiptare” (Onufri), një studim me rëndësi për teorinë dhe metodologjinë e historisë së letërsisë shqipe.

Ndër veprat e tjera të tij janë: “Letërsia shqipe si polifoni”, “Duke lexuar letërsinë e traditës”, “Nga romantizmi drejt rrjedhave të realizmit”, “Përmes mendimit historiko-letrar të Çabejt” (1999), “Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe”, etj. Prof. Ali Xhiku, i cili ka mbajtur edhe detyrën e drejtorit të Institutit të Kulturës Popullore pranë

Akademisë së Shkencave, ishte një nga pedagogët që dha një kontribut të çmuar në studimin e letërsisë shqiptare. Ai është autor i librit studimor “Faqeve të historiografisë shqiptare” (Onufri), një vepër me rëndësi për teorinë dhe metodologjinë e historisë së letërsisë shqipe.

Po ashtu, ai është autor edhe i shumë librave të tjerë me karakter studimor. Ai ka theksuar se historiografia letrare duhet të ndërtohet mbi bazën e teksteve dhe zhvillimeve reale, jo mbi imponime ideologjike. Përmes qasjes krahasimtare dhe metodës kritiko-materialiste, Xhiku ka sjellë një perspektivë të re, duke e vendosur letërsinë shqiptare në dialog me traditat evropiane dhe duke nxjerrë në pah kufizimet e saj historike.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë dhe Komisioni i Përhershëm i Gjuhësisë dhe Letërsisë shprehin ngushëllimet më të thella për humbjen e tij.

Përkujtimi i akademikëve dhe personaliteteve të shquara gjatë muajit korrik

Gjatë muajit korrik, Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujtoi me nderim akademikët, studiuesit dhe personalitetet e shquara të kulturës, letërsisë, historisë dhe albanologjisë që kanë ndërruar jetë ndër vite ose u kujtuan në përvjetorët e lindjes së tyre, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin e mendimit shkencor e kulturor shqiptar. Për ruajtjen e kujtesës akademike, Akademia publikoi një sërë përkujtimoresh kushtuar figurave që kanë dhënë kontribute të rëndësishme në shkencë, arsim, letërsi, albanologji dhe art.

Në kuadër të kësaj veprimtarie u përkujtuan me nderim akademiku Ismail Kadare në 2-vjetorin e ndarjes nga jeta dhe akademiku Aleks Buda, një nga personalitetet më të rëndësishme të historiografisë dhe albanologjisë shqiptare. Po ashtu, u nderuan shkrimtari Shëfqet Musaraj, akademiku Nexhat Daci, studiuesi dhe akademiku Dhimitër Shuteriqi, akademiku Sotir Kuneshka, etnologja akademike Andromaqi Gjergji dhe fizikania, akademikja e asociuar Afërdita Veveçka.

Gjatë muajit korrik Akademia përkujtoi gjithashtu poetët dhe shkrimtarët Arshi Pipa, Ali Podrimja, Martin Camaj, Fatos Arapi dhe Andon Zako Çajupi; studiuesit dhe albanologët Maximilian Lambertz, Johann Georg von Hahn, Kolë Ashta, Sotir Kolea dhe At Shtjefën Gjeçovi; atdhetarin Sotir Peci, klerikun dhe poetin arbëresh Nikollë Keta, si edhe prof. dr. Anastas Dodi. Me rastin e përvjetorit të ndarjes nga jeta, Komisioni i Përhershëm i Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përkujtoi edhe aktorin e shquar Pandi Raidhi, duke vlerësuar kontributin e tij në artin skenik shqiptar.

Përmes këtyre publikimeve, Akademia e Shkencave e Shqipërisë nderoi jetën dhe veprën e figurave të shquara të shkencës, letërsisë, gjuhësisë, historisë, albanologjisë, arteve dhe kulturës kombëtare, duke sjellë në vëmendjen e publikut trashëgiminë e tyre intelektuale dhe kontributin e çmuar në identitetin shkencor e kulturor të vendit.